



**QSHRT**  
QENDRA SHQIPTARE E REABILITIMIT  
TË  
TRAUMËS & TORTURËS

Nr. 106 prot, Datë 26.06.2013



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E POLICISË SË SHTETIT

Nr. 3522 prot, Datë 08.07.2013

## MARRËVESHJE - BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

QENDRËS SHQIPTARE PËR REHABILITIMIN E TRAUMËS & TORTURËS DHE  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT

Për

Parandalimin e torturës, keqtrajtimeve dhe rritjen e nivelit të respektimit të lirive dhe të drejtave të personave që privohen nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit

Tiranë, më 08.07.2013.

Marrëveshja e bashkëpunimit, lidhet sot më datë 08.07.2013, në Tiranë, ndërmjet Qendrës Shqiptare për Reabilitimin e Traumës & Torturës (QShRT) të përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv zoti Adrian KATI dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPP) përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm zoti Hysni BURGAJ,

Në zbatim të nenit 46, të Ligjit nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit", Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" i ndryshuar, ligjin nr. 7727, datë 30.06.1993 "Për Aderimin në Konventën Kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese", ligjin nr. 9094, datë 03.07.2003 "Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës";

Duke vlerësuar si parësore liritë dhe të drejtat e njeriut dhe në veçanti ato për personat që u privohet liria gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit,

Duke konsideruar të rëndësishëm parandalimin e keqtrajtimit, torturës dhe respektimit/garantimit të drejtave të personave që shoqërohen, arrestohen dhe ndalohen në ambientet e Policisë së Shtetit,

**Me qëllim**, vendosjen dhe ndërtimin e mardhënies dhe të raporteve të bashkëpunimit për parandalimin e keqtrajtimit, torturës, respektimit dhe garantimit të lirive dhe të drejtave të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, dokumentimin/investigimin dhe trajtimin e rasteve të akteve të dhunës e keqtrajtimit në ambientet policore, zhvillimin e inspektimit dhe kontrolleve të përbashkëta si dhe zhvillimin e trajnimeve të personelit policor në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut,

Drejtuuesi i Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës & Torturës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, hartojnë dhe miratojnë këtë Marrëveshje - Bashkëpunimi, të detyrueshme për t'u zbatuar nga palët si vijon :

#### I. OBJEKTI I MARRËVESHJES :

- Objekti kryesor i kësaj Marrëveshje është përcaktimi i drejtimit kryesor të bashkëpunimit, modaliteteve për realizimin e tij, parandalimi i keqtrajtimit dhe torturës, respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit.

#### II. BAZA LIGJORE E MARRËVESHJES :

- Ligji nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit,
- Ligji nr. 8328, datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim" i ndryshuar.
- Ligji nr. 7727, datë 30.06.1993 "Për aderimin në Konventën Kundër Torturës dhe Dënimeve, a Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore, ose Degraduese".
- Ligji nr. 9094, datë 03.07.2003 "Për ratifikimin e protokollit opsional të Konventës Kundër Torturës".

#### III. AFATI I MARRËVESHJES:

Është 2 (dy) vjet nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë ripërtëritje.

#### IV. PËRKUFIZIME :

Në kuptimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi termat e mëposhtëm do të kenë këto kuptime :

- a. **Monitorimi** : është procesi i mbledhjes, inspektimit, vëzhgimit dhe vlerësimit të të dhënave, veprimeve, rezultateve dhe praktikave të përbushjes së detyrimeve ligjore për respektimin e garantimit të drejtave të personave nga personeli policor.

- b. **Ekipi monitorues** : është grupi i ekspertëve që kryejnë vizitat/inspektimet monitoruese të profesioneve jurist, psikolog, punonjës social/edukator, mjek dhe specialist i Policisë së Shtetit.
- c. **Raporte inspektimi/monitorimi** : janë aktet administrative dhe dokumentuese që pasqyrojnë gjendjen e konstatuar, mangësitë, shkeljet, nivelin e përmbushjes së standardeve për respektimin e garantimin e të drejtave të kësaj kategorie personash nga Policia e Shtetit.

## V. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE :

Të drejtat dhe detyrimet reciproke midis palëve do të realizohen nga strukturat përgjegjëse reciproke të bashkëpunimit si më poshtë :

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nëpërmjet Drejtorisë së Sigurisë Publike në Departamentin e Sigurisë Publike.
- Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës & Torturës nëpërmjet Ekspertit Juridik.

### IV.1. Të drejtat dhe detyrimet e Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës & Torturës :

1. Të planifikojë dhe bëjë me dije D.P.P planin vjetor të vizitave/inspektimeve në drejtoritë, komisariatet dhe stacionet e policisë në shkallë vendi, në fillim të çdo viti.
2. Paraqitjen e kërkesave në D.P.P me të dhënat për pjesëmarrësit (ekspertët) e grupit të inspektimit/monitorimit duke përcaktuar emrin, atësinë, mbiemrin, profesionin/funksionin që kanë pranë QShRT, numrin e dokumentit identifikues, me qëllim pajisje me autorizime/leje për kryerjen e vizitave në ambientet e drejtorive, komisariateve dhe stacioneve të policisë.
3. Të ofrojë ndihmë nëpërmjet stafit ligjor, mjekësor dhe psikosocial në ato qytete ku ka degët e veta sipas kërkesave të strukturave vendore të policisë.
4. Të kërkojë dhe planifikojë në përbërje të grupeve të inspektimit/monitorimit dhe ekspertë/përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për kryerjen e vizitave/inspektimeve të përbashkëta.
5. Përgatitjen dhe dërgimin në D.P.P të kopjeve të raporteve të inspektimit/monitorimit mbi gjendjen e konstatuar, shkeljet dhe mangësitë në drejtim të respektimit dhe garantimit të të drejtave të personave të shoqëruar dhe të arrestuar/ndaluar, rastet e keqtrajtimit apo të torturave të shkaktuara nga personeli policor, masat dhe rekomandimet që propozohen, etj.
6. Studimin e analizimin e akteve ligjore dhe nënligjore që normojnë aktivitetin e Policisë së Shtetit për respektimin dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të personave që privohen nga liria gjatë veprimtarisë së saj, me qëllim propozimin dhe marrjen e nismave për hartimin e projekteve për shtesa apo ndryshime të kuadrit

ligjor në funksion të parandalimit të keqtrajtmeve, torturës dhe garantimit të të drejtave të personit.

7. Marrjen, evidentimin, verifikimin dhe trajtimin e ankesave të shtetasve lidhur me trajtimin e bërë në ambientet e policisë, keqtrajtimet e bëra apo shkelje të tjera të të drejtave të tyre, duke bërë me dije D.P.P për rezultatet e verifikimit e trajtimit të rasteve konkrete.
8. Të japë asistencë në përgatitjen e kurikulave mësimore dhe për trajnimin e personelit policor në drejtim të njohjes së konventave ndërkombëtare të OKB-së dhe KE-së të ratifikuara nga Shteti Shqiptar lidhur me të drejtat e njeriut dhe në veçanti për personat e privuar nga liria.
9. Të marrë pjesë dhe japë asistencë nëpërmjet ekspertëve të saj në grupet e punës që do të ngrejë D.P.P për përgatitjen e Projekt - Akteve ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe.
10. Të iniciojë dhe organizojë tryeza të rrumbullakëta dhe seminare me pjesëmarrës nga Policia e Shtetit, institucioneve të tjera shtetërore, OJQ e OJF vendase apo të huaja për të bërë prezent situatën në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave të personave në ambientet e policisë, kushteve të ambienteve ku mbahen dhe trajtohen këta persona, rekomandimet dhe masat e propozuara për personelin përgjegjës, etj.
11. Përgatitjen e shtypshkrimeve, buletineve apo broshurave të ndryshme me pjesë nga konventat ndërkombëtare, kushtetuta dhe aktet ligjore e nënligjore që sanksionojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut si dhe shpërndarjen në strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit.
12. Përgatitjen e formularëve për anketime dhe kryerja e tyre lidhur me punën e veprimtarinë e Policisë së Shtetit, respektimin e garantimin e të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit etj, si dhe informimin e D.P.P për rezultatet e anketimit.

#### IV.2. Të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë :

1. Të Pajisë me autorizime/leje të përkohshme stafin e QShRT për kryerjen e vizitave/inspektimit në drejtorinë, komisariatet dhe stacionet e policisë, sipas kërkesave të bëra nga QShRT, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e tyre.
2. Të caktojë e planifikojë ekspertë përfaqësues të strukturave qendrore të Departamentit të Sigurisë Publike në përbërje të grupeve të inspektimit/monitorimit të QShRT -së.
3. Të njihet dhe analizojë raportet e inspektimit/monitorimit të QShRT -së duke përcaktuar masat dhe detyrat që do të kryhen për eliminimin e të metave dhe përmirësimin e gjendjes së konstatuar në drejtim të parandalimit të keqtrajtmeve, torturës e respektimit të të drejtave të personave që mbahen e trajtohen në ambientet e policisë.

4. Të bëjë me dije QShRT -së masat e marra dhe ato që do të merren në vazhdimësi për parandalimin e keqtrajtimeve, torturës, respektimin e garantimin e plotë të të drejtave të personave të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar, përmirësimin e kushteve të ambienteve, përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor, masat disiplinore e penale për personelin policor përgjegjës, problemet apo pengesat e hasura nga institucionet e tjera shtetërore që kanë detyrime në respektimin e të drejtave të arrestuarve/ndaluarve, etj.
5. Të marrë masa për krijimin e kushteve, lehtësirave, vënien në dispozicion të dokumentacionit e stafit policor përkatës grupeve të QShRT-së për përmbushjen e misionit të tyre për inspektimin/monitorimin në drejtoritë, komisariatet dhe stacionet e policisë, sipas Lejeve - Provizore të lëshuara nga D.P.P.
6. Të dërgojë përfaqësues të saj në takimet e përbashkëta, tryezat e rrumbullakëta apo seminarat që do të organizohen nga QShRT -ja e OJQ/OJF të tjera që kanë për objekt të punës së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
7. Të identifikojë nevojat për trajnime të stafit policor që shërbejnë në dhomat e sigurisë për të arrestuarit/ndaluarit dhe shoqëruarit, e kërkojë mbështetjen e dhënien e asistencës nga ekspertë të QShRT -së.
8. Të bashkëpunojë e kërkojë financimin nga QShRT-ja prodhimin e posterave me të drejtat e personave të shoqëruar, arrestuar dhe të ndaluar në ambientet e policisë, parandalimin e dhunës fizike apo psikologjike, keqtrajtimeve të tjera.
9. Informimin e QShRT -së në vazhdimësi për aktet administrative të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë të dërguara për njohje dhe zbatim strukturave qendrore dhe vendore të policisë.

#### IV.3. Detyrimet e përbashkëta :

1. Pikat e kontaktit midis palëve janë si më poshtë :
  - a) Për Qendrën Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës & Torturës:
    - Zj Erinda BLLACA, eksperte juridike, nr. Cel :0682079385
  - b) Për Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit :
    - Drejtues i Parë Ilia NASI, Drejtor i Sigurisë Publike, nr. Cel : 06941 06889.
2. Të shkëmbejnë informacione të ndërsjellta e zhvillojnë takime të përbashkëta pune sa herë që e çmojnë të arsyeshme palët.
3. Sipas situatës dhe gjendjes së paraqitur në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave të personave që shoqërohen, arrestohen dhe ndalohen, të hartojnë e miratojnë Programe - Pune të përbashkëta për daljen nga situata dhe përmirësimin e gjendjes.
4. Kostot financiare për zhvillimin e aktiviteteve që do të kryhen në përmbushje të detyrimeve të kësaj marrëveshjeje do të mbulohen nga QShRT -ja.

5. Palët bien dakord dhe rezervojnë të drejtën të bëjnë ndryshime në marrëveshje sa herë që lind nevoja për ndryshime në detyrimet reciproke apo të përbashkëta.

#### VI. DISPOZITA TË TJERA :

1. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve apo detyrimeve midis palëve, që ka për bazë kjo marrëveshje, bëhet me bisedime dhe mirëkuptim ndërmjet palëve.
2. Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës & Torturës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, nga palët nënshkruese linden të drejta dhe detyrime të parashikuara në këtë marrëveshje.
3. Për zbatimin e kësaj marrëveshje, ngarkohen Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës & Torturës dhe Departamenti i Sigurisë Publike në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me strukturat e saj në varësi.
4. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi përpilohet në 4 (katër) kopje të njëjta, duke marrë secila palë nga 2 (dy) kopje.

DREJTOR EKZEKUTIV I QSHRT

Adrian KATI



DREJTOR I PËRGJITHSHËM  
I POLICISË SË SHTETIT

Hysni BURGAI

